



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "TV DIELLI"  
Nr. i biznesit 71096793  
Pronar – Adem DEMAÇI  
OSHP "TV DIELLI"  
Rr/ Xhelal Mitrovica nr.15  
Prishtinë

Ref: 1501/100/LIC/ni

### VENDIM

për licencimin e ofruesit të shërbimeve programore "TV DIELLI" – me seli në Prishtinë

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distribuimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04), ka hyrë në fuqi më 6 korrik 2007, ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore të cilat programe do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më 29 janar 2015, kandidati për licencë të KPM-së "TV DIELLI", ka parashtruar aplikacionin e kompletuar për licencë të KPM-së, në pajtim me Ligjin dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së.

#### Arsyetimi

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjekte transmetuese.


5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “TV DIELLI”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullores CIMC 2007/04.
6. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “TV DIELLI” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth strukturës së qartë organizative, të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofruar të shërbimeve programore si dhe të dhënave rreth qëndrueshmërisë financiare.
7. Sipas nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, kandidati për licencë të KPM-së “TV DIELLI”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
8. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “TV DIELLI” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së, në pajtim të plotë edhe me Rregulloren e KPM-së për Dhënie të Licencës (KPM-2013/04).

### Vendim

9. Në takimin e datës 24 shkurt 2015, Komisioni merr vendim që, kandidatit për licencë të KPM-së TV DIELLI, me seli në Prishtinë, t’i lëshoj licencën në afat prej dhjetë (10) vitesh nga data e marrjes së vendimit, për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës.

### Lëshimi i Vendimit

10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij. Kandidati mund të fillojë veprimtarinë vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

  
Adnan MEROVCI

Kryetar  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



26.02.2015  
datë